

UDHËZIM
Nr.18, datë 10.6.2005

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 5.4.2005 “PËR
DETYRAT E POLICISË SË SHETITIT DHE FORCAVE TË USHTRISË PËR ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË VITIT 2005”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2005, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Tomor Malaj	Anëtar
Klement Zguri	Anëtar
Dëshira Subashi	Anëtare
Pandeli Varfi	Anëtar
Çlirim Gjata	Anëtar
Dodë Prenga	Anëtar

Në mbështetje të nenit 29 pika 1 dhe nenit 109/1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Neni 1

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“1. Gjatë procesit të numërimit të votave, kur KZZ-ja konstaton se në ambientin e VNV-së janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 109/8, u kërkon atyre që të largohen. Në rast refuzimi, merr vendim për njoftimin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe mban shënim në librin e protokollit.

2. Kur në vendin e numërimit të votave rrezikohet rendi, KZZ-ja me vendim thërret organet e Policisë së Shtetit.

3. Vendimi për kërkimin e ndihmës së vendosjes së rendit i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.

4. Me marrjen e vendimit, Kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZZ-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.

5. Sapo forcat e policisë paraqiten në vendin e numërimit të votave, vendimi për të ndërhyrë u dorëzoht atyre menjëherë.

6. Me rivendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave, KZZ-ja me vendim u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

7. Vendimi i KZZ-së për ndërhyrje merret sipas modelit bashkëngjitur këtij udhëzimi.”

Neni 2

Pika 3 e nenit 10 ndryshon si më poshtë:

“Shoqërimi i kutive të votimit dhe i kutive me materialet e votimit nga KQV-ja në vendin e numërimit të votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.”

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE MODEL-V
KOMISIONI I ZONËS ZGJEDHORE NR. _____

VENDIM

Nr. _____, datë _____.07.2005

PËR NJOFTIMIN E POLICISË SË SHTETIT

Komisioni i Zonës Zgjedhore Nr. _____, sot në orën _____, meqenëse në ambjentin e VNV-së ndodhen persona të paautorizuar dhe/ose rrezikohet rendi, bazuar në nenin 109/8, pika 2, të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Udhëzimin nr.18, datë 10.06.2005 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.5 datë 05.04.2005 "Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të viti 2005",

VENDOSI:

1. Të njoftojë sot në datën _____.07.2005 ora _____ forcat e Policisë së Shtetit për nxjerrjen e personave të paautorizuar dhe/ose rivendosjen e rendit në Vendin e Numërimit të Votave.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë KQZ-së.

Komisioni i Zonës Zgjedhore Nr. _____

	Pro/kundër	Firma
1. _____ Kryetar	_____	_____
2. _____ Zv/kryetar	_____	_____
3. _____ Anëtar	_____	_____
4. _____ Anëtar	_____	_____
5. _____ Anëtar	_____	_____
6. _____ Anëtar	_____	_____
7. _____ Anëtar	_____	_____


VULA

Adresa:
Pallati i Kongresit,
Blvd. Dëshmorët e Kombit,
Tirane.

Tel./Fax:
+355 (4) 23 53 62


Website: www.ccc.org.al

E-mail:
infosac@ccc.org.al



Model i miratuar me Udhëzimin e KQZ-së Nr. 18, datë 10.06.2005

Vendime të Komisionit të Qendrës së Votimit

[illegible]